

VENDIM
Nr. 805, datë 28.12.2023

PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT, MËNYRAVE TË PJESËMARRJES DHE MASËS SË DIETËS DITORE PËR VËSHTIRËSI SHËRBIMI TË PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË ABYEI (UNISFA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit”, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të nenit 3, të aktit normativ nr. 4, datë 20.6.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në *Abyei* (UNISFA)”, miratuar me ligjin nr. 59/2023, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrja e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në *Abyei*, në kufirin midis Sudanit dhe Sudanit të Jugut, do të ketë një kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh, me rotacion deri në 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë. Afati i misionit fillon të llogaritet nga data e dërgimit në mision. Periudhës së qëndrimit në mision i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrje e dorëzim detyre dhe të vonesave të transportit strategjik për ndërrimin me personelin e radhës.

2. Statusi i personelit të Forcave të Armatosura në këtë mision është sipas Marrëveshjes së Statusit të Forcave (SOFA), të datës 20 nëntor 2012, ndërmjet Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe qeverisë së Republikës së Sudanit të Jugut.

3. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë mision, përballon shpenzimet, për:

a) dietat për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) transportimin për në atdhe të individëve të shkëputur të misionit në rast vdekjeje, sëmundjeje, pamundësie për të përfunduar misionin ose thyerjeje disipline;

ç) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së misionit.

4. Transportimi për në atdhe i individëve të shkëputur nga misioni në rast vdekjeje, sëmundjeje, pamundësie për të përfunduar misionin ose thyerjeje disipline përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy-ose shumëpalëshe, ku pala/palët tjetër/e tjera merr/marrin përsipër përballimin e këtyre shpenzime.

5. Ministria e Mbrojtjes bën sigurimin e jetës për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët marrin pjesë në këtë mision.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e dërgimit të personelit në mision.

KRYEMINISTËR

